

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kryeministri**

**U R D H E R**

Nr. 47 , date 10.4.2012

**PER**

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS**  
**PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË REFORMËS NË INSPEKTIVE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

**U R D H Ë R O J:**

1. Ngritjen e grupit ndërinsitucional të punës për monitorimin e zbatimit të reformës në inspektive.
2. Grupi i punës të kryesohet nga Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit Qendror dhe në përbërje të ketë anëtarë, nga një përfaqësues të nivelit të lartë nga:
  - Ministria e Brendshme,
  - Ministria e Mbrojtjes,
  - Ministria e Financave,
  - Ministria e Drejtësisë,
  - Ministria e Punëve Publike dhe Transportit,
  - Ministria e Arsimit dhe Shkencës,
  - Ministria e Shëndetësisë,
  - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta,
  - Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,
  - Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
  - (•) Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave,
  - Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,
  - Kabineti i Kryeministrit,
  - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

3. Grupi i punës ka për detyrë që, në kuadër të zbatimit të reformës në inspektime, për çdo ministri,:

- të bashkërendojë punën dhe të renditë veprimet sipas përparësisë në zbatim të ligjit nr.10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
- të bashkërendojë punën në procesin e ndryshimeve strukturore dhe buxhetore, që do të pësojnë ministritë me krijimin e inspektorateve shtetërore;
- në kuadër të rialokimit të aseteve të ministrive drejt inspektorateve shtetërore, të bashkërendojë procesin e mbështetjes me mjete të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për ndërfaqen me portalin unik të "e-inspection".

4. Grupi i punës ka të drejtë që, në kuadër të zbatimit të reformës në inspektime, për çdo ministri:

- të ftojë ekspertë dhe specialistë, si dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, të subjekteve të inspektimit dhe konsumatorëve për të marr pjesë në takimet e grupit të punës me status këshillimor;
- të kërkojë dhe të marrë, pa pagesë, nga institucionet shtetërore, informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e punës së grupit të punës;
- t'i paraqesë Task-Forcës për Reformën Rregullatore rekomandime në fushën e inspektimit;
- të krijojë grupe pune me status këshillimor për vlerësimin e çështjeve specifike dhe për përgatitjen e propozimeve.

5. Për monitorimin e zbatimit të reformës në\* inspektime, në të gjitha nivelet e saj në ministritë e linjës, grupi i punës të mbështetet nga sekretariatet teknike të mëposhtme:

a) Sekretariati teknik për aspektet legislative-organizative/administrative të reformës, që do të ketë në përbërje:

- Një përfaqësues nga Inspektorati Qendror,
- Sipas rastit, dy deri në pesë përfaqësues të ngarkuar me reformën e inspektimeve nga secila ministri e përfshirë në pikën 2, të këtij urdhri, përveç Ministrisë së Financave. Përfaqësuesit e ministrive të jenë nga drejtori a sektorë të ndryshëm që mbulojnë çështjet juridike, metodologjike, organizative dhe administrative dhe për çështje të personeli lidhur me inspektimet dhe reformimin e tyre, si dhe përfaqësues nga trupat inspektuese të secilës ministri, nëse ka të tilla. Përfaqësuesit të jenë të nivelit drejtues sa më të lartë të mundshëm,

- Një përfaqësues nga Departamenti i Legjislacionit dhe Koordinimit, në Këshillin e Ministrave,
- Një përfaqësues nga Departamenti i Administratës Publike.

b) Sekretariati teknik për aspektet buxhetore/asetet të ketë në përbërje:

- Një përfaqësues nga Inspektorati Qendror,
- Drejtoret e drejtorive ekonomike/shërbimeve mbështetëse të ministrive anëtare të grupit të punës, përveç Ministrisë së Financave,
- Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në Ministrinë e Financave.

c) Sekretariati teknik për "e-Inspection":

- Një përfaqësues nga Inspektorati Qendror;
- Drejtoret e drejtorive të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të ministrive, anëtare të grupit të punës, përveç Ministrisë së Financave;
- Një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

6. Drejtuesit e sekretariateve teknike caktohen nga kryetari i grupit të punës ndërmjet përfaqësuesve të Inspektoratit Qendror.
7. Çdo ministri, përveç Ministrisë së Financave, cakton një përfaqësues si koordinator të përgjithshëm të përfaqësuesve të të tria inspektorateve të përmendura në pikën 5, për reformën e inspektimeve në ministrinë përkatëse.
8. Në mbledhjet e grupit të punës ftohen të marrin pjesë përfaqësues të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, si dhe të grupeve të interesit.
9. Grupi i punës të mbledhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
10. Grupi i punës, në mbledhjen e tij të parë, të hartojë dhe të miratojë një program pune ku të përcaktohen detyra dhe afate konkrete për sekretariatet teknike.
11. Grupi i punës të kontrollojë, në mënyrë periodike, zbatimin e programit të punës dhe të japë udhëzimet përkatëse për zbatimin e tij.
12. Grupi i punës të mbledhet, me njoftimin e kryetarit, jo më pak se një herë në muaj dhe çdo dy javë t'i raportojë Kryeministrit për rezultatet e punës së kryer.
13. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2, që, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e urdhrit, t'i dërgojnë Inspektorit të Përgjithshëm emrat e përfaqësuesve të institucionit të tyre, anëtarë të grupit ndërinsitucional të punës, dhe të përfaqësuesit përkatës në sekretariatet teknike.

14. Ngarkohen drejtuesit e sekretariateve teknike për bashkërendimin e punës ndërmjet grupit ndërinsitucional të punës dhe sekretariateve teknike, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së reformës.
15. Ngarkohet Inspektorati Qendror për mbështetjen materiale e teknike të veprimtarisë së grupit ndërinsitucional të punës.
16. Ngarkohet Inspektori i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**



**SALI BERISHA**

NR.PROT.1077  
DATE 10.4.2012

MINISTRISË SE BRENDSHME  
MINISTRISË SË MBROJTJES  
MINISTRISË SË FINANCAVE  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE  
TRANSPORTS  
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS  
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË  
MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE  
DHE SHANSEVE TË BARABARTA  
MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE  
MBROJTJES SË KONSUMATORIT  
MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË  
DHE SPORTEVE  
MINISTRISË SË MJEDISIT, PYJEVE DHE  
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE  
MINISTRISË SË EKONOMISË , TREGTISË DHE  
ENERGJETIKËS  
AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË  
INFORMACIONIT  
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS  
PUBLIKE  
INSPEKTORATIT QENDROR  
BASHKIMIT TË DHOMAVE TË TREGTISË DHE  
INDUSTRIË TË SHQIPËRISË

Gjergj LEZHJA  
Sekretari i Përgjithshëm

